



Monitoruesi i Prokurimit

Raport mbi Parregullsitë Ligjore të Ministrive,
Komunave dhe Ndërmarrjeve publike

Prill-Qershor 2013



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS

Monitoruesi i Prokurimit

Raport mbi Parregullsitë Ligjore të Ministrive,
Komunave dhe Ndërmarrjeve publike

Prill-Qershor 2013

Programi për Qeverisje të Mirë, financohet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Ky botim është realizuar me përkrahjen nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) - i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Lëvizjes FOL dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së apo KCSF-së.

Projekti “Mbështetja e politikave kundër-korrupsion duke forcuar mbikëqyrjen publike ndaj shërbimeve publike” financohet nga:



**CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS**

Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga Open Society Institute - OSI dhe Civil Rights Defenders - CRD. Qëndrimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë qëndrimet e OSI dhe CRD.

Përmbajtja

Hyrje	3
Përmbledhje Ekzekutive	4
Shkeljet nga ana e ministrive	7
Ministria e Infrastrukturës	7
Ministria e Punëve të Brendshme	9
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	10
Ministria e Shëndetësisë	10
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	11
Shkeljet nga Ndërmarrjet Publike	12
Korporata Energjetike e Kosovës	12
Postë Telekomunikacioni i Kosovës	14
Shkeljet nga ana e Komunave	17
Komuna e Prishtinës	18
Komuna e Gjilanit	20
Komuna e Lipjanit	20
Komuna e Parteshit	20
Komuna e Prizrenit	21
Komuna e Vitisë	22
Komuna e Gjakovës	22
Komuna e Mitrovicës	23
Komuna e Pejës	23
Raportimet e Gazetave Ditore në Fushën e Prokurimit Publik	24
Monitorimet e procedurave të Prokurimit me Pjesëmarrje Direkte	25
Falënderim	
Lëvizja FOL	

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
CRD	Civil Rights Defenders (Mbrojtësit e të Drejtave Civile)
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KK	Komisioni i Konkurrencës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MI	Ministria e Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OE	Operator Ekonomik
OSI	Open Society Institute
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PSH	Paneli Shqyrtues (Organ i OSHP-së)
RrPP	Rregullorja e Prokurimit Publik
UOPP	Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik
FTD	Fleta e dosjes së tenderit

Hyrje

Lëvizja FOL ka dy vite që angazhohet në fushën e Prokurimit Publik. Prokurimi Publik është një ndër instrumentet më të përdorura nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës për harxhimin e parasë publike. Si i tillë është një sektor shumë i ekspozuar ndaj keqpërdorimeve dhe korrupsionit, duke pas parasysh edhe vlerësimin e keq të gjendjes që i bëhet Kosovës vazhdimisht për sa i përket prezencës së korrupsionit dhe keqpërdorimeve në punën e institucioneve nga raportet e organizatave me renome ndërkombëtare, raportet e progresit të komisionit evropian si dhe raportet e organizatave vendore.

Prandaj ky angazhim i FOL-it në prokurim ka ardhur si rezultat i hulumtimeve paraprake, në të cilat është vërejtur që aferat korruptive dhe keqpërdorimet e parasë publike në masë të madhe ndodhin në faza të ndryshme në prokurimin publik, duke përfshirë të dyja nivelet, pra në atë qendrore dhe lokal. Mënyrat që FOL ka zgjedhur për të monitoruar prokurimin publik në institucione janë ato direkte, pra me pjesëmarrje dhe indirekte, përmes hulumtimit të institucioneve dhe të trupave të prokurimit publik. Gjatë kësaj kohe, FOL ka publikuar raporte, analiza dhe reagime të ndryshme në lidhje me politikën e prokurimit publik.

“Monitoruesi i Prokurimit” është njëri ndër këto raporte i cili publikohet rregullisht cdo tre muaj dhe në fund të vitit publikohet raporti vjetor. Ky raport përfshinë dhe bënë interpretim e vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, me qëllim të senzibilizimit të opinionit publik mbi gjendjen e përgjithshme të respektimit të procedurave dhe dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit publik. Sic e dimë, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik është organ i pavarur shqyrtues i cili në bazë të Ligjit për Prokurim Publik 04-L-042 është i autorizuar që të shqyrtojë respektimin e dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave në fjalë.

Në “Monitoruesin e Prokurimit” interpretohen vendimet e OSHP-së të cilat kanë vlerësuar veprimet apo mos-veprimet e institucioneve (Ministrive, Ndërmarrjeve Publike KEK&PTK dhe Komunave) gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik për tenderë të ndryshëm si shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurim Publik në fuqi.

Sikur që të njëjtën gjë kanë bërë raportet paraprake “Monitoruesi i Prokurimit”, edhe ky raport që përfshinë periudhën Prill-Qershor 2013 ka të njëjtën strukturë dhe përmbajtje. Së pari është paraqitur një përmbledhje ekzekutive e të gjeturave të raportit, më pas sipas renditjes shkeljet nga ana e Ministrive, Ndërmarrjeve Publike KEK&PTK dhe Komunave janë interpretuar vendimet e OSHP-së përgjatë këtij tre mujori për secilin institucion në veçanti. Në fund paraqitet një grafik krahasues i shkeljeve të bëra në të njëjtën periudhë të vitit 2012 dhe këtij viti. Po ashtu një raport përshkruet i procedurave të prokurimit në të cilat FOL ka bërë monitorim direkt është bashkangjitur këtij “Monitoruesi të Prokurimit” në fund.

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti “Monitoruesi i Prokurimit Prill-Qershor 2013” përmes të gjeturave të tij tregon që trendi i shkeljeve dhe parregullsive ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit nga ana e Ministrive, Ndërmarrjeve Publike (KEK & PTK) dhe Komunave të Republikës së Kosovës ka vazhduar edhe në këtë periudhë. Në këtë periudhë tre mujore, institucionet e lartë-përmendura kanë bërë shkelje ligjore në gjithsej 29 tenderë të ndryshëm. Nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit prej këtyre 29 tenderëve 14 janë kthyer në ri-vlerësim, 7 janë kthyer në ri-tenderim, 3 janë anuluar, kurse në 5 të tjerë është ndërhyrë në dosjen e tenderit.


Ministritë kanë shkelur dispozitat ligjore të prokurimit publik në 8 tenderë të ndryshëm: a) Ministria e Infrastrukturës me rastin e tenderëve: 1)“Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës 2013”, 2) “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të MI”, 3)“Sinjalizimi dhe mirembajtja e pajisjeve ne rrugën Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës” dhe 4) “Vijimi në kurs të gjuhëve të huaja për personelin e MI”; b) Ministria e Punëve të Brendshme në tenderin “Shërbime hotelerie për nevojat e MPB-së”; c) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në tenderin“Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore”; d) Ministria e Shëndetësisë në tenderin “Furnizime me elektrostimulues dhe defribilator të zemrës”-Ri-tenderim; si dhe e) Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në tenderin “Sigurimi fizik i objekteve në Bërnice”. Nga këta 8 tenderë 2 janë kthyer në **Ri-vlerësim**, 2 në **Ri-tenderim**, 1 është **Anuluar**, kurse në 3 tjerë është **ndërhyrë në dosjen e tenderit**.

Ndërmarrjet Publike (KEK dhe PTK) kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore në 9 tenderë të ndryshëm. Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje ligjore në 5 aktivitete të prokurimit: a) ”Furnizim me kemikalje”; b) “Furnizim me gjysmë fabrikat nga bronza”; c) “Furnizim me kemikalje në TCB”;d) “Liferimi i deflektorëve në kullën ftohëse në TC KosovaB”; si dhe e) “Pjesë për transportin e hirit prej ejektorëve në pompa pneumatike”. Po ashtu PTK ka bërë shkelje ligjore në 4 tenderë të ndryshëm: a) “Furnizim me material teknik për mirëmbajtje”; b) “Furnizim me pjesë rezervë për automjete”; c) “Furnizim me pajisje të IT-së (PC Laptop, Fotokopje, Printer, Projektor, Pjesë për HP EVA 4400, Pajisje të rrjetit dhe server-Lot I”;si dhe d) “Furnizim me material për mirëmbajtje të rrjetave optike”. Nga këta 9 tenderë 7 prej tyre janë kthyer në **Ri-vlerësim** dhe 1 në **Ri-tenderim**, kurse në 1 është **ndërhyrë në dosje të tenderit**.

Komunat kanë bërë shkelje ligjore në gjithsej 12 tenderë të ndryshëm. Komuna e Prishtinës ka shkelur dispozitat ligjore në 4 tenderë të ndryshëm: a) “Furnizim me toner për printer”; b) “Furnizimi dhe montimi i tri njejve të semaforëve dhe sistemit të kontrollit në qytetin e Prishtinës- Lot I”; c) “Ndërtimi i objektit

banesor për familjet në asistencë sociale dhe për nevojat e shpronësimit” si dhe d) “Sigurimi fizik i Autoparkingut ne Zonen Industriale, objektit te ri Komunal, Objektit te Arkivit te Qytetit dhe Objekteve te Qendrave për Punë Sociale”. Komuna e Gjilanit ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Sanimi i rrugëve dhe trotuareve-Mirëmbajtja verore e rrugëve”. Komuna e Lipjanit nuk i ka respektuar dispozitat ligjore në tenderin “Asfaltimi i rrugëve me katër korsi “Shqipëria” dhe “Haradin Bajrami”. Komuna e Parteshit ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Shërbimet inxhinierike për hartimin e projekteve ideore dhe kryesore sipas kërkesave të komunës së Parteshit/Pasjanit”. Komuna e Prizrenit ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Transporti i mësimeve në udhëtar në komunën e Prizrenit”. Komuna e Vitisë ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Shitja e masës drurore (të paprerë)”. Komuna e Gjakovës ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në “Carshia e Madhe” Gjakovë-Ritenderim”. Komuna e Mitrovicës ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Furnizimi dhe vendosja e kamerave në Qytetë”. Dhe Komuna e Pejës në tenderin “Instalimi i kamerave në qytetin e Pejës”. Nga këta 12 tenderë 5 janë kthyer në **Ri-vlerësim**, 4 në **Ri-tenderim**, 2 janë **Anuluar**, kurse në njërin prej tyre **është ndërhyrë në dosjen e tenderit**.


Në periudhën kohore për të cilën raportohet në këtë raport gazetave ditore kanë publikuar gjithsej 40 artikuj të ndërlidhur me fushën e prokurimit publik. Prej tyre 4 kanë qenë raportime hulumtuese: që të 4 në muajin Prill. Kurse 36 artikuj kanë qenë të publikuar në formën e lajmeve: 4 në muajin Prill, 14 në muajin Maj dhe 18 në muajin Qershor.



Graf. 1. Shkeljet e institucioneve dhe ndërmarrjeve publike gjatë periudhës prill-qershor 2013, në procedurat e prokurimit publik

Shkeljet nga ana e Ministrive

Ministritë kanë shkelur dispozitat ligjore të prokurimit publik në 8 tenderë të ndryshëm: a) Ministria e Infrastrukturës me rastin e tenderëve: 1) “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës 2013”, 2) “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të MI”, 3) “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugën Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës” dhe 4) “Vijimi në kurs të gjuhëve të huaja për personelin e MI”; b) Ministria e Punëve të Brendshme në tenderin “Shërbime hotelerie për nevojat e MPB-së”; c) Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në tenderin “Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore”; d) Ministria e Shëndetësisë në tenderin “Furnizime me elektrostimulues dhe defribilator të zemrës”-Ri-tenderim; si dhe e) Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në tenderin “Sigurimi fizik i objekteve në Bërnice”. Nga këta 8 tenderë 2 janë kthyer në Ri-vlerësim, 2 në Ri-tenderim, 1 është Anuluar, kursë në 3 tjerë është ndërhyrë në dosjen e tenderit.



Graf. 2. Shkeljet e ministrive gjatë periudhës prill-qershor 2013, në procedurat e prokurimit publik

Ministria e Infrastrukturës

Ministria e Infrastrukturës ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe rajonale të Kosovës 2013”¹. OE “Magjistrallja” sh.p.k-Gjilan me pretendimin se AK-MI ka bërë shkelje esenciale të dispozitave

¹ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Mire-ver-dhe-dimer-e-rrug.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

të neneve 1, 6, 7, 51, 69 të LPP-së si dhe neneve 3.4 dhe 23.4, 23.6 të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik dhe nenit 8.3 të Rregullores për prokurim publik, ka deponuar ankesë në OSHP. Eksperti shqyrtues i cili është autorizuar nga OSHP-ja për shqyrtimin e vlefshmërisë së kësaj ankesë në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK-MI në dosjen e tenderit për lëndën në fjalë ka vendosur kriteret e përzgjedhjes të cilat i referohen fushës së aktivitetit të prokurimit konform dispozitave të LPP-së, prandaj i ka rekomanduar PSH-së që të refuzohet ankesa e OE ankues si e pa bazuar, dhe ti lejohet AK-së që të vazhdoj më tutje me këtë aktivitet të prokurimit. Meqenëse OE ankues nuk është pajtuar me këtë raport të ekspertit shqyrtues, PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku pasi që ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se AK-MI nuk i ka respektuar dispozitat e neneve 7 dhe 51 të LPP-së sepse të kërkesat mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar në fletën e të dhënave të tenderit është kërkuar që “Vlera e përgjithshme monetare e punëve dhe shërbimeve të ekzekutuara në lëmin e mirëmbajtjes verore dhe dimërore të rrugëve, në tri vitet e fundit për operatorët ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik jo më e vogël se dyfishi i vlerës së ofertës”. Shprehja “mirëmbajtje dimërore dhe verore” është vlerësuar si favorizuese dhe diskriminuese. Prandaj PSH e ka aprovuar ankesën e OE ankues si pjesërisht të bazuar dhe ka urdhëruar shprehjes në fjalë ti shtohet shprehja ekuivalent ose e ngjashme, ndërtimi i rrugës, asfaltimi i rrugëve etj dhe afati për dorëzimin e ofertave të shtyhet për 10 ditë.

Ministria e Infrastrukturës nuk i ka zhvilluar procedurat e prokurimit publik konform dispozitave të LPP-së në tenderin “Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të MI”². Fillimisht AK-MI në mungesë të dy OE ofertues të përgjegjshëm e ka anuluar këtë aktivitet prokurimi. Mirëpo, i pakënaqur me këtë vendim OE ofertues “Siqani”-Prishtinë me pretendimin se ata i kanë plotësuar të gjitha kërkesat nga dosja e tenderit për tu shpallur të përgjegjshëm ka deponuar ankesë në OSHP. PSH e ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se në këtë rast AK-MI nuk i ka respektuar dispozitat e neneve 7, 59 dhe 62 të LPP-së dhe ka rekomanduar që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim. Mirëpo meqë OE ankues nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë dëgjimore ku pasi që ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se OE ankues e ka plotësuar kërkesën që të paraqesë kontratë si dëshmi për punë të ngjashme të kryera në tri vitet e fundit me vlerë monetare sa dyfishi i ofertës. Prandaj PSH ka konstatuar se vlerësimet e ekspertit shqyrtues për shkeljet e AK-MI qëndrojnë si të tilla dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

AK-MI nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugën Nacionale dhe Rajonale të Republikës së Kosovës”³. OE “Tek Ing Consulting” Sh.p.k-Prishtinë duke pretenduar se AK-MI duke vendosur kriteret përjashtuese dhe diskriminuese në dosjen e tenderit, ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 7 të LPP-së, ka deponuar ankesë në OSHP. OSHP pas pranimit

² <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Servisimi-dhe-mirambajtja-e-atuomjeteve-te-mi.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

³ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Sinjal-dhe-miremb.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

të ankesës, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar lëndën, i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK-MI nuk ka respektuar nenet 7 dhe 52 të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave për tenderin në fjalë dhe ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të urdhërohet AK-MI që të ndryshojë kriteret për dhënie të kontratës dhe të zgjasë afatin për marrjen e dosjes së tenderit. Meqenëse AK-MI nuk është pajtuar me këtë raport të ekspertit shqyrtues, PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku pasi ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se raporti i ekspertit shqyrtues është i qëndrueshëm pasi që AK-MI ka bërë shkelje të neneve 7 dhe 52 duke vënë kriteret favorizuese me të cilat iu është dhënë mundësi vetëm OE që kanë realizuar projekte të mëdha të marrin pjesë në këtë tenderë. Prandaj PSH ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka urdhëruar AK-MI që të ndryshojë kriteret favorizuese dhe të bej njoftimin e te gjithë operatoreve ekonomik pjesemarrës për këtë aktivitet të prokurimit dhe të zgjas afatin për dorëzimin e ofertave.

AK-MI ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Vijimi në kurs të gjuhëve të huaja për personelin e MI”⁴. Fillimisht OE “London School of English” si palë e pakënaqur me vendimin e AK-MI që të rekomandojë për kontratë OE “Prishtina Language Academy” ka deponuar ankesë në OSHP, duke pretenduar se me këtë rast AK-MI ka bërë shkelje të dispozitave të neneve 1.1, 59.1, 59.4 dhe 60.1 të LPP-së. Kjo për arsye se sipas OE ankues OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar gjitha njesit-pozicionet në specifikimin e çmimeve, prandaj edhe në leximin e hapjes së ofertave ky OE ka ofruar çmim më të ulët ndërsa në total të përgjithshëm ka çmim shumë më të lartë se OE ankues. OSHP pasi që ka pranuar ankesën ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ka konstatuar se AK-MI në këtë rast ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe ka rekomanduar që ankesa e OE ankues të cilësohet si e pabazuar. Pasi që OE ankues nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë dëgjimore, ku pas dëgjimit të të gjitha palëve dhe shoshitjes së të gjitha provave ka konstatuar se qëndron pretendimi i OE ankues se çmimi i OE të rekomanduar për kontratë ndryshon rrënjësisht nga ajo çka pretendojnë AK-MI dhe eksperti shqyrtues. Prandaj PSH e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka urdhëruar që lenda të kthehet në Ri-tenderim.

Ministria e Punëve të Brendshme

Ministria e Punëve të Brendshme ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Shërbime hotelerie për nevojat e MPB-së”⁵. Fillimisht OE “Shqiponja” N.T.H-Drenas ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se AK-MPB gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit ka bërë shkelje të dispozitave të neneve 59.2, 61 paragrafi 2.1, 2.2, dhe 2.4 të LPP-së, nenit 35.9 dhe 36 të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik si dhe nenit 17 të Rregullores për Prokurim Publik, duke qenë se oferta e OE

⁴ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Vijini-ne-kurs-te-gjuheve-te-huja.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

⁵ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Mpb-sherb-hotel.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

ankues është konsideruar si ofertë me çmime jo-normalisht të ulëta nga ana e komisionit vlerësues të ofertave. Ekspertja shqyrtuese e cila është autorizuar nga ana e OSHP-së për shqyrtimin e vlefshmërisë së kësaj ankese në raportin e saj të ekspertizës ka konstatuar se AK-MPB ka bërë shkelje të neneve 59, 61 dhe 62 të LPP-së, nenit 35.9 të UOPP si dhe nenit 17 të RrPP. Prandaj ka rekomanduar që PSH të aprovoj si të bazuar ankesën e OE ankues dhe AK-MPB të anulohet kështu tender. Meqenëse AK-MPB nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor, ku pasi që ka ndërgjyatur të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se vërehet se disa çmime për njësi të ofruara nga ana e OE ankues janë jo normalisht të ulëta. Por AK-MPB ka gjetur zhvillimit të procedurave ka bërë shkelje të neneve 59 dhe 62 të LPP-së si dhe nenit 35.9 të UOPP pasi që nuk e ka bërë vlerësimin e ofertave në përputhje me këtë dispozita ligjore. Prandaj ankesa e OE ankues është aprovuar si e bazuar dhe është urdhëruar AK-MPB që të Anulojë këtë tender.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nuk i ka zhvilluar procedurat e prokurimit në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së në tenderin “Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore”⁶. OE “ESG” N.P.SH-Prishtinë si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës OE “Qendra Kosovare për Zhvillim”-Gjakovë për tenderin në fjalë, duke pretenduar se në këtë rast AK-MBPZHR ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të neneve 28, 51, 59, 60, 65, 66 dhe 69 të LPP-së, ka deponuar ankesë në OSHP. OSHP pas pranimit të ankesës ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK-ja në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale pika 9.1 ka kërkuar që OE të ofrojë dëshmi për tre (3) agronom -inxh, të diplomuar të bujqësisë, ndërsa OE ankues ka ofruar parakontrata për agronom-inxh. Prandaj i ka rekomanduar PSH që të refuzojë ankesën e OE ankues. Meqenëse OE ankues nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë dëgjimore, ku pasi që ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se "Parakontrata është kontratë me të cilën merret përsipër detyrimi që më vonë të lidhet kontrata tjetër kryesore " dhe se në këtë rast AK-MPB ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së. Prandaj PSH e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Ministria e Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë nuk i ka zhvilluar procedurat e prokurimit në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së për aktivitetin e prokurimit “Furnizime me elektrostimulues dhe defribilator të zemrës”-Ri-tenderim⁷. OE “Kosova Med” si palë e pakënaqur me dosjen e tenderit dhe specifikimet teknike për tenderin në fjalë ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se AK-MSH ka bërë shkelje të dispozitave të neneve 7, 28 dhe 29 të LPP-së. Eksperti shqyrtues i cili është

⁶ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Zona-rurale-permes-avancimit.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

⁷ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/furn-me-elektrostimulues.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)


autorizuar nga ana e OSHP për shqyrtimin e vlefshmërisë së ankesës në raportin e tij të ekspertizës, ka konstatuar AK-MSH ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe ka rekomanduar që ankesa të refuzohet si e pabazuar. Pasi që OE ankues nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë dëgjimore ku ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat. Më pas PSH ka konstatuar se AK-MSH ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e neneve 7, 27 dhe 28 të LPP-së meqenëse përmes kërkesave të specifikimit teknike, iu është bërë e pamundur që të ofertojnë OE të tjerë përveç një OE të caktuar. Prandaj PSH ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka obliguar AK-MSH që të ndryshojë dhe plotësojë specifikimet teknike në përputhje me nenet e lartpërmendura të LPP-së.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Sigurimi fizik i objekteve në Bërnice”. Fillimisht OE “SFK”-Prishtinë ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se AK-MTI ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 7 pikat 1, 2, 4, 5 dhe 6 dhe nenit 60 pika 1.1 të LPP-së. OSHP pas pranimit të ankesës ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës e cila në raportin e saj të ekspertizës ka konstatuar se AK-MTI në rastin në fjalë nuk e ka bërë vlerësimin e ofertave në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe ka rekomanduar PSH-së që lëndën ta kthejë në ri-tenderim. AK-MTI nuk është pajtuar me këtë raport dhe PSH ka shqyrtuar të gjitha provat relevante dhe ka konstatuar që kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, nuk janë në përputhje me natyrën dhe llojin e prokurimit. Po ashtu as OE i rekomanduar për kontratë dhe as OE të tjerë pjesëmarrës nuk e kanë përmbushur obligimin për pagën minimale e cila është dashur të jetë kërkesë obligative-mandatore në dosjen e tenderit. Prandaj PSH e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e OE ankues dhe i ka rekomanduar AK-MTI që lëndën ta kthejë në Ri-tenderim.

Shkeljet e Ndërmarrjeve Publike⁸

Ndërmarrjet Publike (KEK dhe PTK) kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore në 9 tenderë të ndryshëm. Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje ligjore në 5 aktivitete të prokurimit: a) "Furnizim me kemikalje"; b) "Furnizim me gjysmë fabrikat nga bronza"; c) "Furnizim me kemikalje në TCB"; d) "Liferimi i deflektorëve në kullën ftohëse në TC KosovaB"; si dhe e) "Pjesë për transportin e hirit prej ejektorëve në pompa pneumatike". Po ashtu PTK ka bërë shkelje ligjore në 4 tenderë të ndryshëm: a) "Furnizim me material teknik për mirëmbajtje"; b) "Furnizim me pjesë rezervë për automjete"; c) "Furnizim me pajisje të IT-së (PC Laptop, Fotokopje, Printer, Projektor, Pjesë për HP EVA 4400, Pajisje të rrjetit dhe server-Lot I"; si dhe d) "Furnizim me material për mirëmbajtje të rrjetave optike". Nga këta 9 tenderë 7 prej tyre janë kthyer në Ri-vlerësim dhe 1 në Ri-tenderim, kurse në 1 është ndërhyrë në dosje të tenderit.



Graf. 3. Shkeljet e ndërmarrjeve publike gjatë periudhës prill-qershor 2013, në procedurat e prokurimit publik

Korporata Energjetike e Kosovës

Korporata Energjetike e Kosovës - KEK gjatë periudhës Prill-Qershor 2013, ka bërë shkelje ligjore në 5 aktivitete të ndryshme të prokurimit.

KEK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin "Furnizim me kemikalje"⁹. Fillimisht OE "Toni&Pateting"-

⁸ Duke qenë se ekzistojnë shumë ndërmarrje publike, FOL monitoron vetëm dy ndërmarrjet kryesore në vend: KEK-un dhe PTK-në.

Ferizaj/Beograd dhe “EuroEnergji”- Fushë Kosovë si palë të pakënaqura me njoftimin për dhënie të kontratës OE “Ripten Engineering”-Prishtinë kanë deponuar ankesë pranë OSHP-së duke pretenduar se AK-KEK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të neneve 56, 59, 60 dhe 69 të LPP-së. OSHP pasi që ka pranuar ankesën ka autorizuar ekspertët për shqyrtimin e lëndës, të cilët në raportin e tyre ekzaminues kanë konstatuar se AK-KEK në përgjithësi nuk i ka zhvilluar procedurat e prokurimit konform LPP-së për shkak se nuk kanë respektuar kërkesën decidive të dosjes së tenderit që OE fitues të posedojë “Autorizim nga prodhuesi” dhe kanë rekomanduar që të anulohet ky aktivitetet prokurimi dhe ankesat e OE ankues të vlerësohen si të bazuara. Pasi që AK-KEK nuk është pajtuar me këtë raport të ekspertëve, PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku pas dëgjimit të të gjitha palëve dhe shoshitjes së të gjitha provave ka konstatuar se OE i rekomanduar për shpërblim me kontratë nuk ka qenë i përgjegjshëm për arsye se nuk ka plotësuar kërkesën mbi mundësinë teknike/profesionale të nenit 9.2 të FTD-së që të posedojë autorizim nga prodhuesi. Prandaj PSH ka ardhur në përfundim që ka shkelje të nenit 56 dhe 59 dhe 32.4 meqë nuk kanë qenë të paktën 2 OE ofertues të përgjegjshëm. Për këto arsye PSH ka aprovuar ankesat si pjesërisht të bazuara dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

KEK nuk i ka zhvilluar procedurat e prokurimit konform LPP-së në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me gjysmë fabrikat nga bronza”¹⁰. Për rastin në fjalë OE ofertues “Auto Kosova”-Gjilan duke pretenduar se AK-KEK ka shkelur dispozitat e neneve 59 dhe 69 të LPP-së pasi që ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit, ka deponuar ankesë në OSHP. Eksperti shqyrtues i cili është autorizuar nga OSHP-ja për shqyrtimin e vlefshmërisë së këtij pretendimi në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar se AK-KEK në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e neneve 7 dhe 59 të LPP-së dhe ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**. PSH ka mbajtur seancë dëgjimore pasi që AK-KEK nuk është pajtuar me këtë raport të ekspertit shqyrtues, ku pas ndëgjimit të të gjitha palëve dhe shoshitjes së të gjitha provave, ka konstatuar se konstatimet e ekspertit shqyrtues qëndrojnë si të tilla, prandaj ka aprovuar si të bazuar ankesën dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

KEK nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Furnizim me kemikalje në TCB”¹¹. Fillimisht OE “Bel Ju Trade”-Maqedoni si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë pranë OSHP-së me pretendimin se iu është bërë diskriminim nga ana e AK-KEK, pasi që ata me kohë kanë bërë kërkesën për tërheqjen e dosjes së tenderit në dy

⁹ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/F_kemik.pdf (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

¹⁰ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/furniz-me-gjysme-fab.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

¹¹ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Furniz-me-kemikal-tcb.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

e-maila zyrtar të paraqitur në njoftimin për kontratë por atyre nuk iu është dorëzuar dosja nga ana e AK-KEK dhe në këtë mënyrë AK-KEK ka bërë shkelje të neneve 7 dhe 48.1 të LPP-së. OSHP pasi që ka pranuar ankesën ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se ankesa është e bazuar dhe ka rekomanduar që ky tender të kthehet në Ri-tenderim. Meqenëse AK-KEK nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor, ku pasi ka ndërgjatur të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se ankesa është e bazuar dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në Ri-tenderim.

OE “Bel Ju Trade”-Maqedoni duke pretenduar se tri herë ka bërë kërkesë për tërheqjen e dosjes dhe e njëjta nuk i është dorëzuar nga ana e AK-KEK, një ankesë të llojit të njëjtë ndaj AK-KEK e ka deponuar në OSHP edhe për tenderin “Liferimi i deflektorëve në kullën ftohëse në TC KosovaB”¹². Eksperti shqyrtues i cili është autorizuar nga OSHP për shqyrtimin e kësaj anekese në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se në tenderin na fjalë AK-KEK nuk ka respektuar dispozitat e neneve 7 dhe 48 të LPP-së dhe ka rekomanduar që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe AK-ja të anulohet këtë tender. Pasi që AK-KEK nuk është pajtuar me këtë raport, PSH ka mbajtur senacë të shqyrtimit kryesor ku pasi që ka ndërgjatur të gjitha palët dhe ka shoshitur të gjitha provat relevante ka konstatuar që rekomandimet e ekspertit shqyrtues qëndrojnë si të tilla. Prandaj e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka obliguar AK-KEK që të shtyjë afatin e pranimit të ofertave edhe për 10 ditë për tenderin në fjalë dhe ti dorëzojë dosjen e tenderit OE ankues.

KEK nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Pjesë për transportin e hirit prej ejektorëve në pompa pneumatike”¹³. OE “Xani Inex”-Prishtinë ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se AK-KEK ka bërë shkelje të nenit 69 të LPP-së duke bërë shkelje të kërkesave teknike/profesionale të dosjes së tenderit duke rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar këto kërkesa. OSHP ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se ankesa e OE ankues është e bazuar dhe ka rekomanduar që lënda të kthehet në Ri-vlerësim. Meqenëse edhe OE ankues edhe AK-KEK janë pajtuar me këtë raport procedura e ankesës ka përfunduar në këtë fazë.

Postë-Telekomi i Kosovës

Postë-Telekomi i Kosovës - PTK gjatë periudhës Prill-Qershor 2013 nuk i ka respektuar dispozitat ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit në 4 tenderë të ndryshëm:

¹² <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Liferi-i-deflektorece-ne-kulle.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

¹³ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Pjese-per-trans-e-hirit-prej-ejektoreve.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

AK-PTK nuk i ka zhvilluar procedurat e prokurimit konform LPP-së në tenderin “Furnizim me material teknik për mirëmbajtje”¹⁴. Fillimisht OE “InterAdria”-Prishtinë si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës OE “Telenorma”-Prishtinë duke pretenduar se në këtë rast AK-PTK ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 59 të LPP-së ka deponuar ankesë në OSHP. Eksperti shqyrtues i autorizuar nga ana e OSHP-së pas pranimit të ankesës për shqyrtimin e lëndës në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK-PTK nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave për tenderin në fjalë dhe ka rekomanduar PSH-së që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në Ri-vlerësim. Pasi që AK-PTK nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë dëgjimore ku pasi ka dëgjuar të gjitha palët dhe ka shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se pretendimi i OE ankues se AK-PTK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së qëndron për arsye se OE ankues pavarësisht se ka plotësuar kriteret për përzgjedhje të kërkuara në fletën e të dhënave të tenderit respektivisht ka ofruar kontrata për furnizime të ngjashme me Forcën e sigurisë dhe PTK-në është eliminuar nga ana e AK-PTK. Prandaj PSH e ka vlerësuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

AK-PTK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për aktivitetin prokurimit “Furnizim me pjesë rezervë për automjete”¹⁵. Pasi që AK-PTK ka rekomanduar për kontratë OE “Miri”, operatori tjetër ekonomik ofertues “Global Parajsa” i pakënaqur me këtë vendim ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se AK-PTK ka bërë shkelje të dispozitave të neneve 7 dhe 59 të LPP-së. OSHP pas pranimit të ankesës ka autorizuar ekspertin shqyrtues që të shqyrtojë vlefshmërinë e këtyre pretendimeve i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK-PTK gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar kërkesat mbi mundësitë teknike/profesionale të FDT-së, dhe në këtë mënyrë ka bërë shkelje të neneve 7 dhe 59 të LPP-së. Prandaj i ka rekomanduar PSH-së që lënda të kthehet në Ri-vlerësim. PSH pasi që është njoftuar se AK-PTK nuk pajtohet me këtë raport ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku pasi që ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se AK-PTK ka vepruar në kundërshtim me nenet 7 dhe 59 të LPP-së dhe ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues. Prandaj ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

PTK nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Furnizim me pajisje të IT-së (PC Laptop, Fotokopje, Printer, Projektor, Pjesë për HP EVA 4400, Pajisje të rrjetit dhe server-Lot I”¹⁶. OE “Botek”-Prishtinë në cilësinë e palës së pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës OE “Asseco”-Prishtinë, ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se me këtë veprim AK-PTK ka bërë shkelje të dispozitave të neneve 7, 28, 59.2, 59.4 dhe 60.1.1 të LPP-së. OSHP pas pranimit të kësaj ankesë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar lëndën, i cili në

¹⁴ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Furnizim-me-material-teknik-per-mirembajtje.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

¹⁵ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Furniz-me-pjese-rez-per-auto.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

¹⁶ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/llap_top_print_projektor.pdf (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK-PTK gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka marrë për bazë specifikimet teknike të detyrueshme ashtu siç janë kërkuar në Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe rrjedhimisht ka bërë shkelje të neneve 7, 59 dhe 60 të LPP-së. Prandaj ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe tenderi të kthehet në Ri-vlerësim. Pasi që AK-PTK nuk është pajtuar me këtë raport, PSH ka mbajtur seancë dëgjimore ku pasi që ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se raporti i ekspertit shqyrtues qëndron si i tillë, prandaj e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

PTK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Furnizim me material për mirëmbajtje të rrjetave optike”¹⁷. OE “Kineting sh.p.k”-Prishtinë ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se në këtë rast AK-PTK ka bërë shkelje të dispozitave të neneve 27, 28, 58, 59, 60 dhe 69 të LPP-së sepse OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit. OSHP pas pranimit të ankesës ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se ankesa e OE ankues është e bazuar dhe ka rekomanduar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**. Meqenëse edhe OE ankues edhe AK-PTK janë pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues procedura e ankesës ka përfunduar në këtë fazë.


Po ashtu PTK gjatë këtij tre mujori përmes një vendimi të PSH me nr 43/2013 të datës 03.07.2013 është gjobitur me gjobë në lartësi prej 50,000.00E ndërsa zyrtarit të prokurimit i është tërhequr vërejtja e fundit. Kjo ka ardhur si rezultat i mos-zbatimit nga ana e AK-PTK të vendimit me nr 43/2013 të datës 26.03.2013 sipas ankesës së OE “ENBI POËER& G3 ENGINEERING” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Linjave dhe Trafostacioneve të tensionit të mesme 10/20/0.4kv, 50kva dhe 50Hz ne 10 lokacione”¹⁸. Ky vendim është interpretuar në raportin paraparak “Monitoruesi i Prokurimit Janar-Mars 2013”.

¹⁷ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Furniz-me-mater-te-rrjet-optike.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

¹⁸ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Nder-i-linjave-trafo-te-tens-te-mesem-ptkk.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

Shkeljet nga ana e Komunave

Komunat kanë bërë shkelje ligjore në gjithsej 12 tenderë të ndryshëm. Komuna e Prishtinës ka shkelur dispozitat ligjore në 4 tenderë të ndryshëm: a) “Furnizim me toner për printer”; b) “Furnizimi dhe montimi i tri njejve të semaforëve dhe sistemit të kontrollit në qytetin e Prishtinës- Lot I”; c) “Ndërtimi i objektit banesor për familjet në asistencë sociale dhe për nevojat e shpronësimit” si dhe d) “Sigurimi fizik i Autoparkingut në Zonën Industriale, objektit të ri Komunal, Objektit të Arkivit të Qytetit dhe Objekteve të Qendrave për Punë Sociale”. Komuna e Gjilanit ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Sanimi i rrugëve dhe trotuareve-Mirëmbajtja verore e rrugëve”. Komuna e Lipjanit nuk i ka respektuar dispozitat ligjore në tenderin “Asfaltimi i rrugëve me katër korsi “Shqipëria” dhe “Haradin Bajrami”. Komuna e Parteshit ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Sherbimet inxhinierike për hartimin e projekteve ideore dhe kryesore sipas kërkesave të komunës së Parteshit/Pasjanit”. Komuna e Prizrenit ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Transporti i mësimdhënësve udhëtar në komunën e Prizrenit”. Komuna e Vitisë ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Shitja e masës drurore (të paprerë)”. Komuna e Gjakovës ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në “Çarshia e Madhe” Gjakovë-Ritenderim”. Komuna e Mitrovicës ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Furnizimi dhe vendosja e kamerave në Qytet”. Dhe Komuna e Pejës në tenderin “Instalimi i kamerave në qytetin e Pejës”. Nga këta 12 tenderë 5 janë kthyer në **Ri-vlerësim**, 4 në **Ri-tenderim**, 2 janë **Anuluar**, kurse në njërin prej tyre është **ndërhyrë në dosjen e tenderit**.



Graf. 4. Shkeljet e komunave gjatë periudhës prill-qershor 2013, në procedurat e prokurimit publik

Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Furnizim me toner për printer”¹⁹. OE “INK Station” N.T.P- Ferizaj si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, duke pretenduar se gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin në fjalë AK-KK Prishtinë ka bërë shkelje të dispozitave të neneve 27, 28 dhe 59 të LPP-së. OSHP pas pranimit të kësaj ankesë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar se AK-KK Prishtinë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të neneve 27, 41, 59 dhe 69 të LPP-së si dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ të Prokurimi Publik pjesa B dhe ka rekomanduar PSH-së që të urdhëroj AK të anulojë këtë tender. Meqenëse AK-KK Prishtinë është pajtuar vetëm pjesërisht me këtë raport PSH ka mbajtur seancë dëgjimore ku pasi që ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se AK në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, për faktin se komisioni i vlerësimit të ofertave ka vlerësuar se për këtë aktivitet të prokurimit kemi katër ofertat të përgjegjshme, në realitet për këtë aktivitet të prokurimit ka vetëm një ofertë të përgjegjshme. Përveç kësaj PSH ka konstatuar se AK ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 7 dhe 28 të LPP-së, prandaj e ka aprovuar si të bazuar dhe ka urdhëruar që tenderi të **Anulohet**.

AK-KK Prishtinë po ashtu nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe montimi i tri njejeve të semaforëve dhe sistemit të kontrollit në qytetin e Prishtinës- Lot I”²⁰. OE “EkoInvest& La Semaforica”-Prishtinë-Padovë si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës OE “RSM Company Shpk&Elektrosoft”-Prishtinë-Shkup, duke pretenduar se në këtë rast AK-KK Prishtinë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të neneve 10, 11 dhe 59 të LPP-së, ka deponuar ankesë në OSHP. Eksperti shqyrtues i cili është autorizuar nga OSHP-ja për shqyrtimin e lëndës në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit që të paraqesë autorizim të vlefshëm nga prodhuesi dhe po ashtu garancion nga prodhuesi. Prandaj eksperti shqyrtues ka ardh në përfundim se vlerësimi i ofertave nga ana e AK nuk është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe OE ofertues nuk janë trajtuar në përputhje me nenin 7 të LPP-së. Për këto arsye ai ka rekomanduar PSH-së që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të kthehet lënda në ri-vlerësim. Pasi që AK-KK Prishtinë nuk është pajtuar me këtë rekomandim të ekspertit shqyrtues, PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku pasi që ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat relevante ka ardh në përfundim që konstatimet e raportit të ekspertit shqyrtues qëndrojnë si të tilla. Prandaj, PSH ka aprovuar ankesën e OE ankues si të bazuar dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

¹⁹ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Furniz_me-toner_per-print.pdf (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

²⁰ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Furniz-dhe-mont-i-tri-nyjeve-te-semaf.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

Tenderi i tretë gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit të të cilit AK-KK Prishtinë nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së është “Ndërtimi i objektit banesor për familjet në asistencë sociale dhe për nevojat e shpronësimit”²¹. OE “CTA”-Prishtinë si palë e pakënaqur me dosjen e tenderit dhe specifikimet teknike të kapacitet teknike dhe financiare ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se AK-KK Prishtinë ka bërë shkelje të dispozitave të nenëve 7 dhe 53 të LPP-së me kërkesat nën pikat 3.2.3 dhe 3.2.4 të dosjes së tenderit ku është kërkuar qarkullimi për vitet 2010-2011-2012 në shume prej 2 milion euro, dy kontrata pek ndertime të larta në vlerë prej 500.000€, referenca për punë të kryera brenda katër tri viteve se paku 1 milion euro, pastaj numri i punëtorëve të paraqitur në ATK mesatarisht 30 punëtor në vit, të prezantohen për secilin vit listat e ATK. OSHP pas pranimit të ankesës ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me nenet 10 dhe 53 të LPP-së, dhe ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar kurse AK-KK Prishtinë të zgjat afatin e marrjes së dosjes dhe të ofroj informata dhe qasje të mjaftueshme për tenderin në fjalë. Meqenëse AK-KK Prishtinë nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë dëgjimore ku pasi ka dëgjuar të gjitha palët dhe ka shoshitur të gjitha provat relevante nuk ka aprovuar pretendimet ankimore të OE ankues lidhur me kapacitetet ekonomike dhe financiare mirëpo ka vlerësuar AK ka bërë shkelje të nenit 53 të LPP-së. Prandaj ankesën e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar dhe ka obliguar AK-KK Prishtinë që të veprojë më tutje në pajtim me dispozitat e nenit 53 të LPP-së duke ofruar informata dhe qasje të mjaftueshme në dokumente zyrtare për OE ofertues në lidhje me tenderin në fjalë.

AK-Prishtinë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së edhe gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Sigurimi fizik i Autoparkut në Zonën Industriale, objektit të ri Komunal, Objektit të Arkivit të Qytetit dhe Objekteve të Qendrave për Punë Sociale”²². OE “KSF Rojet e Nderit shpk”-Prishtinë si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës OE “King Security”-Prishtinë dhe “SKF Security”-Prishtinë ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se me këtë rast AK-KK Prishtinë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të nenit 7 të LPP-së dhe Ligjit të Punës në fuqi nr. 04/ L-003. Eksperti shqyrtues i cili është autorizuar për shqyrtimin e lëndës nga OSHP-ja, në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar se sipas kërkesës së dosjes së tenderit, OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotësojnë pagën minimale, me çmimet e ofruara në ofertat e tyre siç e parasheh Ligji i Punës në fuqi dhe vendimi i Qeverisë për pagën minimale për punëtorët mbi moshën 35 vjeçare. Prandaj, eksperti shqyrtues ka konstatuar që ankesa e OE ankues është e bazuar dhe ka rekomanduar OSHP-së që lënda të kthehet në ri-vlerësim. AK-KK Prishtinë përmes parashtresës ka njoftuar se nuk pajtohet me këtë raport të ekspertit shqyrtues dhe për këtë arsye PSH ka mbajtur seancë dëgjimore, ku pasi që ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se vlerësimet e ekspertit shqyrtues qëndrojnë si të tilla. Prandaj, ankesën e OE ankues e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

²¹ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Ndert-i-obj-banes-ne-asist.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

²² <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Sigur-fiz-auto-ne-zonen-ind.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për aktivitetin e prokurimit “Sanimi i rrugëve dhe trotuareve-Mirëmbajtja verore e rrugëve”²³. Fillimisht OE “Magjistrallja” sh.p.k-Gjilan si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës OE “Integral”sh.p.k- Prishtinë ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se në këtë rast AK-KK Gjilan ka bërë shkelje të dispozitave të neneve 7, 56 paragrafi 1.1 dhe 1.2, 59, 60 dhe 69 të LPP-së si dhe nenit 17.1 të RrPP, neneve 35.1, 35.2, 35.5, 35.6, 35.10, 35.11,37.2 dhe 37.5 të UOPP. OSHP pas pranimit të ankesës e ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK-KK Gjilan i ka zhvilluar procedurat e prokurimit në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe ka rekomanduar që ankesa të refuzohet si e pabazuar. Meqenëse OE ankues nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku pasi ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat relevante dhe duke pasur parasysh që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi se pajisjen traktor e ka në pronësi, ka konstatuar se AK-KK Gjilan me rastin e vlerësimit të ofertave për tenderin në fjalë nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së. Prandaj, e ka aprovuar ankesën e OE ankues si pjesërisht të bazuar dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në **Ri-tenderim**.

Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit nuk i ka zhvilluar procedurat e prokurimit në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së për tenderin “Asfaltimi i rrugëve me katër korsi “Shqipëria” dhe “Haradin Bajrami”²⁴. Fillimisht OE “Eskavatori”-Ferizaj si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës OE “Bageri”-Ferizaj ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se në këtë rast AK-KK Lipjan ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të neneve 6, 7, 59, 60, 64 dhe 65 të LPP-së. Eksperti shqyrtues i cili është autorizuar nga OSHP-ja për shqyrtimin e vlefshmërisë së kësaj ankese në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar se qëndrojnë si të tilla pretendimet ankimore të OE ankues se nuk është respektuar neni 7 dhe AK tek kërkesat teknike profesionale ka kërkuar specifikime që kanë për qëllim të favorizoj ose të eliminoj konkurrencën në mes të operatoreve ekonomike. Po ashtu eksperti shqyrtues ka konstatuar që AK gjatë zhvillimit të procedurave nuk ka respektuar nenet 59 dhe 60 të LPP-së, dhe duke ë marrë parasysh të gjitha këto të gjetura ka rekomanduar që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe ankesa të aprovohet si e bazuar. Për arsye se AK-KK Lipjan nuk është pajtuar me këtë raport PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku pas dëgjimit të të gjitha palëve dhe shoshitjes së të gjitha provave relevante ka konstatuar se qëndrojnë si të tilla të gjeturat e raportit të ekspertit shqyrtues. Prandaj PSH e ka aprovuar të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka urdhëruar AK që lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

²³ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Sanimi-i-rrug-dhe-trotuareve.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

²⁴ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Asfalt-i-rrug-kk-lipjan.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

Komuna e Parteshit

Komuna e Parteshit ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin "Shërbimet inxhinierike për hartimin e projekteve ideore dhe kryesore sipas kërkesave të komunës së Parteshit/Pasjanit"²⁵. OE "Sh.p.k EM-EM"-Prishtinë ka deponuar ankesë në OSHP lidhur me tenderin në fjalë duke pretenduar se AK-Komuna e Parteshit ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 60 paragrafi 1.1 të LPP-së. OSHP pas pranimit të ankesës e ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK-KK Partesh nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartv të gjithë operatorët ekonomik dhe të eliminoj konkurrencën në mes të operatoreve ekonomike, dhe njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe nenin 59 të LPP-se, pasi autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE që nuk ka qenë i përgjegjshëm, pra nuk i përmbush kriteret në dosjen e tenderit. Prandaj, eksperti shqyrtues ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe tenderi të kthehet në **Ri-vlerësim**. Procedura e ankesës ka përfunduar në këtë fazë pasi që AK-KK Partesh është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues.

Mirëpo, me vendimin e OSHP-së nr. 152/13²⁶ të datës 12.07.2013 AK-Komuna e Parteshit është dënuar më një gjobë prej 10.000,00 Euro dhe zyrtarit të prokurimit i është anuluar certifikata e prokurimit pikërisht për arsye të mos-respektimit të vendimit të OSHP-së të lartë përmendur i cili ishte marrë me datë 13.06.2013.

Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit ka bërë të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin "Transporti i mësimdhënësve udhëtar në komunën e Prizrenit"²⁷. OE "Halimaj Reisen"-Prizren si palë e pakënaqur që Shoqata "Kosova e lirë" është rekomanduar që të shpërblehet me kontratë ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se shoqata në fjalë është jo-profitabile dhe nuk ka të drejtë të shpërblehet me tender sepse kjo është në kundërshtim me ligjin e OJQ-ve nr. 03L/-134 dhe po ashtu OE ankues ka pretenduar se është eliminuar nga procedura pa të drejtë më arsyetimin se nuk i plotëson të gjitha kushtet. OSHP pas pranimit të kësaj ankese ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se në këtë rast AK-KK Prizren ka vepruar në kundërshtim me nenet 27 dhe 59 të LPP-së dhe ka rekomanduar PSH-së që të aprovoj si të bazuar ankesën e OE ankues dhe tenderin ta anulojë. Meqenëse AK nuk është pajtuar më këtë raport të ekspertit shqyrtues, PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku pasi që ka dëgjuar të gjitha palët dhe shohitur të gjitha provat ka konstatuar se AK ka bërë shkelje të nenit 7 duke qenë se nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të

²⁵ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Sherbimet-inxhinierike.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

²⁶ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Sherb-inxhi-per-hart-kryesor-pp.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

²⁷ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Trans-i-misim-kk-pz.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

gjithë OE pjesëmarrës, dhe po ashtu AK ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së duke qenë se ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar kushtet e dosjes së tenderit kurse atë që i ka plotësuar këto kushte e ka shpallur të papërgjegjshëm. Po ashtu PSH ka konstatuar se është bërë shkelje e nenit 17 pika 1, 2 dhe 3 e Ligjit për Lirin e Asociimit në Organizata Joqeveritare. Prandaj PSH e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE ankues dhe ka urdhëruar AK-KK Prizren që të Anulojë këtë tender.

Komuna e Vitisë

Komuna e Vitisë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Shitja e masës drurore (të paprerë)”²⁸. Fillimisht OE “NTP Frashëri”-Viti si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës OE “ NTSH Bujari” në lidhje me tenderin në fjalë ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se AK-KK VITI në këtë rast ka bërë shkelje ligjore të LPP-së. OSHP menjëherë pas pranimit të ankesës ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e vlefshmërisë së këtyre pretendimeve i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK-KK Viti në rastin në fjalë ka bërë shkelje të nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2010 të MBPZHR pasi që ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk ka kryer asnjë punë të kësaj natyre siç parashihet në këtë nenë. Për arsye se AK-KK Viti nuk është pajtuar me këtë konstatim të ekspertit shqyrtues, PSH ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku pasi ka dëgjuar të gjitha palët dhe shoshitur të gjitha provat ka konstatuar se të gjeturat e raportit të ekspertit shqyrtues qëndrojnë si të tilla. Prandaj, PSH e ka aprovuar ankesën e OE ankues si të bazuar dhe ka urdhëruar AK që lëndën ta kthejë në Ri-tenderim.

Komuna e Gjakovës

Komuna e Gjakovës nuk i ka zhvilluar procedurat e prokurimit në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së për tenderin “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në “Çarshia e Madhe” Gjakovë-Ritenderim”²⁹. Fillimisht OE “RSM Company sh.p.k”-Prishtinë si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënie të kontratës OE “Dellova”-Rahovec, ka deponuar ankesë në OSHP duke pretenduar se në këtë rast AK-KK Gjakovë ka bërë shkelje të neneve 68 dhe 69 të LPP-së dhe nenit 9.1 të dosjes së tenderit. Ekspertja shqyrtuese e cila është autorizuar nga OSHP-ja për shqyrtimin e lëndës në raportin e saj të ekspertizës ka konstatuar se AK në tenderin në fjalë nuk i ka respektuar nenet 56 dhe 59 të LPP-së pasi që ka shpall fitues OE i cili nuk ka përmbush kushtet administrative duke mos ofruar çertifikatë valide të TVSH-së. Për këtë arsye i ka rekomanduar PSH-së që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. PSH pas dëgjimit të të gjitha palëve dhe shoshitjes së të gjitha provave në seancë dëgjimore ka konstatuar se të gjeturat e raportit të ekspertit shqyrtues qëndrojnë si të tilla, prandaj ankesën e ka aprovuar si të bazuar dhe ka urdhëruar që lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

²⁸ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Dru-te-paprere.pdf>(Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

²⁹ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/ndert-i-infrast-rrug.pdf>(Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

Komuna e Mitrovicës


Komuna e Mitrovicës ka bërë shkelje të dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Furnizimi dhe vendosja e kamerave në Qytet”³⁰. OE “NTP Pro 4”-Prishtinë duke pretenduar se në këtë rast AK-KK Mitrovicë ka bërë shkelje të nenit 28 të LPP-së ka deponuar ankesë në OSHP. OSHP pas pranimit të kësaj ankesë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e lëndës i cili në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se AK nuk i ka respektuar nenet 28 dhe 59 të LPP-së dhe ka rekomanduar që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në **Ri-tenderim**. Meqenëse edhe OE ankues edhe AK-KK Mitrovicë janë pajtuar me këtë raport procedura e ankesës ka përfunduar në këtë fazë.

Komuna e Pejës

Komuna e Pejës nuk i ka zhvilluar procedurat e prokurimit në përputhje me dispozitat e LPP-së për tenderin “Instalimi i kamerave në qytetin e Pejës”³¹. Fillimisht OE “Profesional Alarm”-Prishtinë duke pretenduar se AK-KK Pejë ka bërë shkelje të neneve 7, 59 dhe 60 të LPP-së ka deponuar ankesë në OSHP. Eksperti shqyrtues i autorizuar nga OSHP-ja për shqyrtimin e lëndës në raportin e tij ekzaminues ka konstatuar se në këtë rast AK ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 59 të LPP-së për arsye se ka rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Prandaj, i ka rekomanduar PSH-së që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në **Ri-tenderim**. Meqenëse edhe OE ankues edhe AK-KK Pejë janë pajtuar me këtë raport procedura e ankesës ka përfunduar në këtë fazë.

³⁰ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Furnizimi-dhe-vend-e-kam.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)

³¹ <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2013/Instalimi-i-kam-ne-qytetin-e-pejes.pdf> (Është qasur për herë të fundit me datë 30.07.2013)




Graf. 5. Paraqitja krahasimtare e shkeljeve të institucioneve dhe ndërmarrjeve publike përgjatë tremujorit të dytë të viteve 2012-2013, në procedurat e prokurimit publik

Raportimet e Gazetave në Fushën e Prokurimit Publik³²

Raportimet e gazetave ditore në fushën e prokurimit publik përbëjnë një rëndësi të jashtëzakonshme për informimin e opinionit publik në lidhje me parregullsitë dhe shkeljet në këtë fushë. Si rrjedhojë ato mund të kontribuojnë edhe në reduktimin e këtyre shkeljeve dhe parregullsive.

Në periudhën kohore për të cilën raportohet në këtë raport gazetat ditore kanë publikuar gjithsej 40 artikuj të ndërlidhur me fushën e prokurimit publik. Prej tyre 4 kanë qenë raportime hulumtuese: që të katërtit në muajin Prill. Kurse 36 artikuj kanë qenë të publikuar në formën e lajmeve: 4 në muajin Prill, 14 në muajin Maj dhe 18 në muajin Qershor.

Përgjatë periudhës tremujore Prill-Qershor 2012 gazetat ditore kanë publikuar gjithsej 62 artikuj të ndryshëm të ndërlidhur me fushën e prokurimit publik. Prej këtyre 62 artikujve gazetaresk 21 kanë qenë raportime hulumtuese: 6 në muajin prill, 8 në muajin maj dhe 7 në muajin qershor. Ndërkaq, 41 sosh kanë qenë të publikuara në formën e lajmeve: 13 në muajin prill, 23 në muajin maj dhe 5 sosh në muajin maj.



Graf. 6. Paraqitja krahasimtare e raportimeve të medieve të shkruara rreth shkeljeve dhe keqpërdorimeve në prokurimin publik përgjatë tremujorit të dytë të viteve 2012-2013

³² Në kuadër të hulumtimit tonë kemi zgjedhur vetëm katër gazetat kryesore ditore në Kosovë: Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe Tribuna.

Monitorimi i Procedurave të Prokurimit me pjesëmarrje direkte

Lëvizja FOL ashtu siç u cek edhe në hyrje të këtij raporti përveç monitorimit të respektimit të dispozitave ligjore të LPP-së nga ana e autoriteteve kontraktuese me metodën indirekte përmes interpretimit të vendimeve të OSHP-së, po ashtu tash e më shumë se 2 vite realizon edhe monitorime me pjesëmarrje direkt në cilësinë e monitoruesit në procedurat e prokurimit në autoritetet kontraktuese me të cilat ka Memorandume Mirëkuptimi.

Lëvizja FOL ka Memorandum të Mirëkuptimit për të realizuar monitorime me pjesëmarrje direkt tw procedurave tw prokurimit me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës, Ministrinë e Administratës Publike, Ministrinë e Integritetit Evropian, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe me Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.


Në bazë të këtyre Memorandumeve të Mirëkuptimit Lëvizja FOL gjatë tremujorit të dytë të këtij viti ka monitoruar me prezencë direkt procedurat e prokurimit për 37 tenderë të ndryshëm në autoritete kontraktuese të lartpërmendura.

Nga këto 37 aktivitete të prokurimit, 20 lloje kanë qenë Kontratë për Furnizime, 9 lloje kanë qenë për Kontratë për Punë, 6 lloje kanë qenë Kontratë për Shërbime dhe një ka qenë kontratës e kombinuar Punë/Furnizime dhe një Furnizime dhe Shërbime.

Procedurat e Prokurimit për tenderët e lartpërmendur janë zhvilluar në këto autoritete kontraktuese: 10 në Shërbimin Korrektues të Kosovës, 10 në Ministrinë e Drejtësisë, 6 në Ministrinë e Administratës Publike, 7 në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 1 në Komunën e Novobërdës, 1 në Komunën e Shtërpçës, 1 në komunën e Kllokotit, 1 tender ka qenë i shpallur për dy autoritete kontraktuese Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Si rezultat nga këta 37 tenderë në 23 prej tyre janë shpallur operatorët ekonomik fitues, 11 prej tyre janë anuluar për shkak të mungesës së të paktën 2 Operatorëve Ekonomik ofertues të përgjegjshëm ashtu siç parashihet në nenin 32 paragrafi 4 të LPP-së, në dy procedura është shpallur fituesi vetëm për lot-in e parë ndërsa për të dytin nuk ka pasur fitues dhe një ende nuk ka mbaruar.

Lëvizja FOL gjatë monitorimit të procedurave të prokurimit vazhdimisht përpjekjet që përmes rekomandimeve të japë kontributin e saj që procedurat në fjalë të zhvillohen në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së. Raporte me rekomandime dhe të gjetura gjatë monitorimeve iu dërgohen strukturave udhëheqëse të autoritetit kontraktues përkatës çdo herë që Lëvizja FOL vlerëson se ka nevojë për një gjë të tillë.



Graf. 7. Numri i procedurave të prokurimit të monitoruara nga Lëvizja FOL gjatë periudhës prill-qershor 2013

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur - OSF dhe Mbrojtësit e të Drejtave Civile -CRD si dhe Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe menxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Ky Raport është produkt i stafit të Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: www.levizjafol.org.

Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.

*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytëtarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*



Rr. Andrea Gropa, Nr. 35. 10000 Prishtinë, Kosovë

Mob.: +377 (0) 44 131 542 | www.levizjafol.org | info@levizjafol.org